



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**  
**SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE TRAJNIMEVE**

Nr. 3127/1 Prot.

Tiranë, më 08/11 /2023

**OFERTE – PUNE**

Universiteti Bujqësor i Tiranës shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmës akademik në kategorinë “Specialist” në Departamentin e Drejtim Agrobiznesit, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Konkursi do të zhvillohen në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, godina a në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në datën 05.12.2023 në orën 13<sup>00</sup>.

Të interesuarit do të dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike të Universitetit Bujqësor të Tiranës jo më vonë se data 30.11.2023.

Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i nevojshëm janë të bashkëngjitura.

**ADMINISTRATORI**  
**Edmond TËRTHORJA**

**REKTORI**  
**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 3127/2 Prot.

Tiranë, më 08/11 /2023

**Lënda:** Kriteret e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë për vend të lirë pune personel ndihmës akademik në kategorinë "Specialist" pranë Departamentit të Drejtim Agrobiznesit në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA).

**POZICIONI:** "Specialist" në Departamentin Drejtim Agrobiznes (FEA).

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22/7/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 57, neni 66, Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, neni 23, Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik & Ndihmës në UBT, Kërkesa me nr. 3127 prot, datë 11.10.2023 nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, "Mbi plotësimin e 1 (një) vendi të lirë pune si personel ndihmës akademik në kategorinë "Specialist", shpallen për t'u plotësuar nga kandidatët që do të konkurrojnë, kriteret e vlerësimit si më poshtë:

**I. KRITERE TE PERGJITHESHME**

I	KRITERE – ELIMINUESE
1	Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në të dy nivelet: Bachelor dhe/ose Master i Shkencave ose Diplomë e Integruar (Arsim i Lartë) në fushat e fakultetit të shkenca sociale/të natyrës, brenda dhe jashtë vendit.  Të ketë të paktën 2(dy) vite punë, eksperiencë pune..
<b>Shënim:</b> Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.	

**II. KRITERE TE VEÇANTA**

I	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË E DOSJES SË KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Master Profesional	7
	Master i Shkencave	10
2	Përvojë pune	
	• Për çdo dy vjet eksperiencë	2
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	
	• Për kurs kualifikimi brenda vendit (të vërtetuar me dëshmi ose dokumente të tjera) nr. Kursesh*pikët për secilin.	1

	dokumente të tjera ), nr. Kursesh* pikët për secilin.	
4	<b>Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi.</b>	
	• Gjuhë Angleze	5
	• Gjuhe të tjera	3
5	<b>Aftësi në programe kompjuterike, të vërtetuara me dëshmi.</b>	2
<b>TOTALI PIKEVE TË DOSJES: (70%) e Totalit prej 100 pikësh (max 70 pikë)</b>		
<b>TOTALI PIKEVE NGA INTERVISTA ME GOJË: (30%) e Totalit prej 100 pikësh (max 30 pikë)</b>		

**Shënim:**

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike dhe Komisioni i rekrutimit bëjnë vlerësimin e dosjes sipas përcaktimeve të mësipërme.
- Diferencën e pikëve për shumën 30% kandidati e merr nga intervista.

**Kujdes & Konsideroni:**

- Konferenca ndërkombëtare do të konsiderohen të gjitha ato që zhvillohen (i) jashtë shtetit me bord organizator dhe shkencor dhe procedings nga një Universitet ose Institucionin tjetër ndërkombëtar dhe (ii) ato që organizohen në Shqipëri nga njeri nga Universitetet Publike të Tiranës (UBT, UT, UP) me bord organizator dhe shkencor dhe procedings; që përmban titullin ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë kërkues nga shumë vende.
- Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit.
- Në kushtet kur ka më pak se dy kandidatë konkurimi shtyhet.

**REKTORI**  
**Prof.Dr. Fatbardh SALLAKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 3127/13 Prot

Tiranë, më 08/11 /2023

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT  
QË KONKUROJNË**

1. Kërkesën për vendin e punës që do të konkurrojnë.
2. Dokumentin e identifikimit.
3. CV me fotografi.
4. Diplomën të shoqëruar me listën e notave.
5. Kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit, duhet të kenë bërë njohjen e diplomës.
6. Librezën e punës.
7. Librezën e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.
8. Dy referenca nga punëdhënësi ose nga pedagogë për të sapodiplomuarit.
9. Dëshmitë e gjuhëve të huaja të niveleve të përcaktuara tek kriteret.
10. Formularin e vetdeklarimit (te shkarkohet nga faqja e DAP-it).
11. Deklaratën personale që nuk ka konflikt interesi.
12. Raportin mjekësor për aftësinë në punë.
13. Dëshmi penaliteti për punë
14. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
15. Vërtetim nga prokuroria.
16. Dokumentacioni duhet të jetë i noterizuar, kur nuk është në original.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**

